

-- ndërtimin e ushtrimoreve, fushave të sport shtëpive të kulturës fizike dhe objekteve tjera për kulturë fizike dhe sport.

KREU II

CAKTIMI I INTERESIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 3

Interesi i përgjithshëm për ndërtimin e objektit të caktuar respektivisht për zhvillimin e punëve tjera në pasurinë e patundshme për të cilën ekziston plani i hollësishëm urbanistik, caktohet me atë plan.

Në qoftë se vendimi për ndërtimin e objektit të caktuar respektivisht zhvillimin e punimeve tjera në pasurinë e patundshme e ka marrë Kuvendi i komunës në mbledhje respektivisht Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës, e nuk ekziston plani i hollësishëm urbanistik, interesi i përgjithshëm për ndërtimin e atij objekti në tokën e cila duhet të ekspropriohehet caktohet me atë vendim.

Interesin e përgjithshëm për kërkimin e pasurisë minerale ose të ndonjë pasurie tjetër natyrore e përcakton Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 4

Në qoftë se ndërtesa në të cilën ekziston e drejta e pronësisë e për të cilën mendohet ekspropriimi gjendet në tokën e pronësisë shoqërore e cila me planin urbanistik respektivisht hapësiror ose me vendimin që e zëvendëson atë plan është paraparë për ndërtimin e banesave, ndërtimin e objekteve komunale, sipërfaqeve publike ose për kryerjen e punimeve të tjera për nevojat komunale, interesi i përgjithshëm për atë ndërtim në tokën në të cilën gjendet ndërtesa caktohet në atë plan ose me vendim i cili e zëvendëson atë plan.

Vendimi i kuvendit të komunës i cili e zëvendëson planin urbanistik, pos tjerash duhet të përmbajë kufitë e tokës dhe qëllimin për të cilin mund të përdoret ajo.

Dispozitat e alineve 1 dhe 2 të këtij neni nuk aplikohen nëse është fjala për një ndërtesë të tillë e cila, sipas planit urbanistik ose sipas vendimit i cili e zëvendëson atë plan, mund të ekzistojë në atë vend, e është në gjendje të tillë që nuk ka nevojë të rënxohet.

Neni 5

Në rastin kur interesi i përgjithshëm nuk është caktuar në bazë të neneve 3 dhe 4 ekspropriimi mund të propozohet vetëm pasi që organi kompetent shtetëror sipas propozimit të arsyetuar të shfrytëzuesit të ekspropriimit, të ketë marrë vendimin (neni 6) se ndërtimi i objektit në vend të caktuar ka interes të përgjithshëm dhe se mund të fillojë ekspropriimi.

Neni 6

Në qoftë se vendimin mbi ndërtimin e objektit të caktuar respektivisht kryerjen e punimeve tjera në pasurinë e patundshme, për të cilat nuk është nxjerrë plani i hollësishëm urbanistik, e ka marrë organizata e punës së bashkuar ose organizata tjetër apo organi shtetëror, pos organit shtetëror nga neni 3 alineja 3 të këtij ligji, vendimin mbi atë se ndërtimi i atij objekti në tokën për të cilën mendohet të propozohet ekspropriimi ka interes të përgjithshëm, e merr në mbledhje Kuvendi i komunës në territorin e së cilës gjendet ajo tokë.

Në qoftë se toka gjendet në territorin e disa komunave, vendimin mbi caktimin e interesit të përgjithshëm e merr Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës.

L I G J I

MBI EKSPROPRIIMIN

(Teksti i spastruar)

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Ekspropriimi i pasurisë së paluejtshme bëhet sipas dispozitave të këtij ligji dhe sipas dispozitave të Ligjit mbi ekspropriimin të Republikës Socialiste të Serbisë, të cilat në mënyrë unike aplikohen në tërë territorin e Republikës.

Neni 2

Pasuria e patundshme mund të ekspropriohehet kur kjo është e nevojshme me qëllim ndërtimit të objekteve ekonomike, banimi, komunale, shëndetësore, kulturore dhe objekteve tjera me interes të përgjithshëm.

Pasuria e patundshme mund të ekspropriohehet edhe kur kjo është e nevojshme me qëllim zhvillimi të punimeve tjera me interes të përgjithshëm.

Pasuria e patundshme mund të ekspropriohehet veçanërisht për:

- për ndërtimin e hekurudhave, rrugëve urave, aeroporteve, kanaleve si dhe për ngritjen e ndërtesave dhe stabilimenteve të destinuara për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e këtyre objekteve;
- ndërtimin e centraleve për prodhimin e energjisë elektrike dhe stabilimenteve për bartjen dhe shpërndarjen e energjisë së këtyre;
- ngritjen dhe zgjerimin e fabrikave dhe stabilimenteve të tyre, hapjen dhe zgjerimin e minierave;
- ngritjen e stabilimenteve telegrafike, telefonike dhe të rrjetës së radios dhe televizionit;
- kërkimin e pasurive xeherore dhe pasurive tjera në brendinë e tokës;
- rregullimin e ujërave rrjedhore dhe rrëqeve;
- ujëtarjen, tharjen, asanacionin dhe meliorimin e tokës;
- pyllzimin;
- ngritjen e vendbanimeve, rrugëve, parqeve, shesheve dhe skuereve;
- ndërtimin e ujësjellësve, kanalizimit, gazpërçuesve, varrezave dhe objekteve tjera komunale;
- ndërtimin e ndërtesave të banimit dhe ndërtesave afariste;
- ndërtimin e silloseve, fidanishteve, stacioneve për farë dhe shtim;
- ndërtimin e shkollave, muzeumeve, galerive të artit dhe objekteve tjera për qëllime arsimore e kulture;
- ndërtimin e spitaleve, vendeve për shërim dhe objekteve tjera për qëllime shëndetësore e sociale;

Me paraqitjen e padisë, me të cilën hapet konflikti administrativ kundër atij vendimi, nuk ndërprehet procedura sipas propozimit për ekspropriim.

Vendimi mbi ekspropriimin i nxjerrë para përfundimit të konfliktit administrativ nuk mund të ekzekutohet dhe shfuqizohet nëse me aktvendimin e nxjerrë lidhur me atë konflikt është anuluar ose abroguar vendimi me të cilin caktohet se ndërtimi i objektit ka interes të përgjithshëm dhe se mund të fillojë ekspropriimi.

KREU III

PUNËT PREGATITORE RRETH EKSPROPRIIMIT

Neni 7

Ai i cili mendon të propozojë ekspropriimin mund të kërkojë që, për hartimin e elaboratit investiv, për paraqitjen e propozimit për caktimin e interesit të përgjithshëm ose për paraqitjen e propozimit për ekspropriim, t'i lejohej të bëjë përgatitjet e nevojshme në pasurinë e patundshme të caktuar siç janë ekzaminimi i tokës, matjet e tjera.

Neni 8

Në propozimin për lejen e kryerjes së punimeve përgatitore duhet të theksohet: qëllimi për të cilin mendohet të propozohet ekspropriimi, pasuria e patundshme në të cilën propozuesi mendon të bëjë punimet përgatitore pronari i asaj pasurie të patundshme, natyra, vëllimi dhe qëllimi i punimeve dhe koha e zgjatjes së tyre.

Në lidhje me propozimin për lejimin e kryerjes së punimeve përgatitore vendos organi komunal i administratës kompetent për punët juridike-pasurore.

Neni 9

Në qoftë se paraqitësi i propozimit për lejen e kryerjes së punimeve përgatitore provon se ato punime janë të nevojshme për qëllimet eaktuara me këtë ligj, organi kompetent do t'i lejojë punimet e tilla përgatitore.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi lejimin e kryerjes së punimeve përgatitore, organi kompetent kujdeset që ato punime mos të bëhen në kohë të papërshtatshme për pronarin e pasurisë së patundshme, duke pasur parasysh kulturën e tokës dhe qëllimin për të cilën ai e shfrytëzon pasurinë e patundshme.

Në vendim, pos tjerash, duhet të shenohen punimet përgatitore të cilat mund të bëhen si dhe afati deri në të cilin duhet të kryhen. Me këtë vendim nuk mund të lejohen punimet ndërtimore dhe punimet tjera të ngjashme.

Neni 10

Kundër vendimit të marrë sipas propozimit për dhënie e lejes së kryerjes së punimeve përgatitore, mund të paraqitet ankesa.

Neni 11

Ai në dobi të të cilit është lejuar kryerja e punimeve përgatitore, është i obliguar që për këtë t'i paguajë shpërblimin pronarit të pasurisë së patundshme.

Dispozitat e këtij ligji mbi shpërblimin për zënie e përkohshme (neni 74) dhe mbi procedurën për caktimin e lartësisë së atij kompenzimi, aplikohen edhe me rastin e dhënies së lejes për kryerjen e punimeve përgatitore.

KREU IV

VENDIMI MBI EKSPROPRIIMIN

Neni 12

Propozimin për ekspropriimin mund të paraqesë bashkësia shoqërore-politike, organizata e punës së bashkuar, bashkësia vetëqeverisëse e interesit, bashkësia lokale, organizata shoqërore-politike, organizata shoqërore e caktuar me ligj, dhe organizata dhe bashkësia e tjetër vetëqeverisëse (shfrytëzuesi i ekspropriimit) vetëm pasi të jetë përcaktuar sipas dispozitave të këtij ligji interesi i përgjithshëm për ndërtimin e objektit, respektivisht për zhvillimin e punimeve të tjera.

Propozimi për ekspropriim i paraqitet organit komunal të administratës kompetent për punët juridike-pasurore.

Në emër të bashkësisë shoqërore-politike dhe bashkësisë lokale propozimin për ekspropriimin e paraqet avokati publik.

Kur ekspropriimi bëhet në dobi të komunës e për nevojat e shfrytëzuesit, avokati publik e paraqet propozimin për ekspropriim dhe kryen punë të tjera në procedurën e ekspropriimit dhe të caktimit të shpërblimit për pasurinë e paluejtshme të ekspropriuar.

Në qoftë se interesi i përgjithshëm është caktuar me vendim të kuvendit komunal, propozimi për ekspropriim mund të paraqitet në afatin prej dy vjetësh prej ditës së marrjes së atij vendimi.

Neni 13

Në propozimin për ekspropriimin e pasurisë së patundshme duhet të shënohen:

1. propozuesi i ekspropriimit,
2. shfrytëzuesi për nevojat e të cilit bëhet ekspropriimi,
3. pasuria e patundshme për të cilën propozohet ekspropriimi dhe vendi ku gjendet ajo pasuri e patundshme,
4. pronari i pasurisë së patundshme për të cilën propozohet ekspropriimi vendbanimi ose selia e tij,
5. objekti respektivisht punimet për të cilat propozohet ekspropriimi.

Neni 14

Propozimit për ekspropriim i bashkangjiten:

1. ekstrakti nga librat e tokave ose librat tjera publike në të cilat regjistrohet pronësia në pasuri të patundshme, e i cili përmban shënime mbi pasurinë e patundshme për të cilën propozohet ekspropriimi respektivisht shënime kadastrale etj. nëse ato libra nuk ekzistojnë,

2. vërtetimi i shërbimit të kontabilitetit shoqëror lëshuar në pajtim me Ligjin mbi ndërtimin e objekteve investive, se propozuesi i ekspropriimit respektivisht personi shoqërore-juridik për nevojat e të cilit bëhet ekspropriimi i ka të siguruara mjetet e nevojshme për pagimin e kompenzimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuar,

3. dokumenti për caktimin e interesit të përgjithshëm për ndërtimin e objektit.

Në qoftë se interesi i përgjithshëm për ndërtimin e objektit respektivisht për kryerjen e punimeve të tjera është caktuar me vendim të marrë në bazë të nenit 3, alineja 2 të këtij ligji, propozimit të ekspropriimit i bashkangjitet akti i kuvendit të komunës respektivisht Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës, me të cilin vërtetohet se me vendim të atij organi është caktuar lokacioni i ngushtë i cili përfshinë tokën për të cilën mendohet të propozohet ekspropriimi.

Në qoftë se interesi i përgjithshëm është caktuar në lejen e organit kompetent për punën lidhur me hulumtimin e pasurisë xeherore e pasurisë tjetër (neni 3 alineja 3), propozimit të ekspropriimit i bashkangjitet ajo leje.

Në qoftë se interesi i përgjithshëm është caktuar në bazë të planit urbanistik ose vendimit i cili zëvendëson atë plan (neni 4), propozimit të ekspropriimit i bashkangjitet ekstrati nga plani ose vendimi përkitazi me kufijt e tokës dhe qëllimin për të cilin mund të përdoret ajo.

Në qoftë se interesi i përgjithshëm është caktuar me vendimin e organit shtetëror kompetent (neni 6 dhe 7) propozimit të ekspropriimit i bashkangjitet si vendim.

Në qytete dhe në vendbanime me karakter të qytetit dokumentacionin nga alineja 1 gjer 5 të këtij neni ia dërgon avokatit kompetent publik personi shoqëroro-juridik për nevojat e të cilit bëhet ekspropriimi.

Neni 15

Vendimin sipas propozimit për ekspropriim e merr organi komunal i administratës kompetent për punët pasurore-juridike në territorin e të cilit gjendet pasuria e patundshme, në bazë të dispozitave të Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative.

Para se të nxjerrë vendimin, ky organ do të marrë në pyetje pronarin e pasurisë së patundshme.

Neni 16

Vendimi me të cilin aprovohet propozimi për ekspropriim, pos tjerash, përmban:

1. shejimin e aktit në bazë të të cilit është caktuar interesi i përgjithshëm;
2. shejimin e shfrytëzuesit të ekspropriimit ndërsa në qytete dhe në vendbanime me karakter të qytetit edhe të personit shoqëroro-juridik për nevojat e të cilit bëhet ekspropriimi;
3. shejimin e pasurisë së patundshme e cila ekspropriohet, duke i numruar shënimet nga librat e tokave, e nëse pasuria e patundshme nuk është regjistruar në librin e tokave ose në libër tjetër publik në të cilin regjistrohet pasuria e patundshme, duke cekur shënimet kadastrale;
4. shejimin e pronarit të pasurisë së patundshme të ekspropriuar dhe vendbanimin e tij ose selinë;
5. objektin dhe punimet për të cilat ekspropriohet pasuria e patundshme.

Neni 17

Kundër vendimit të organit komunal të administratës kompetent për punët pasurore-juridike, i cili është marrë në bazë të propozimit për ekspropriim, mund të paraqitet ankesa pranë organit kompetent të shkallës së dytë për punët pronësore-juridike.

Neni 18

Propozuesi i ekspropriimit është i obliguar që bashkë me propozimin për ekspropriim njëherit të paraqes dhe kërkesën për regjistrimin e ekspropriimit në librat përkatëse publike në të cilat regjistrohen të drejtat faktike në pasuri të patundshme.

Tjetërsimi i pasurisë së patundshme në lidhje me vënjen e shënimit të ekspropriimit nuk ka ndikim juridik ndaj shfrytëzuesit të ekspropriimit.

Neni 19

Shpenzimet e procedurës së ekspropriimit në lidhje me marrjen e vendimit mbi ekspropriimin i paguan shfrytëzuesi i ekspropriimit.

Neni 20

Shfrytëzuesi i ekspropriimit e fiton të drejtën e posedimit në pasurinë e patundshme të ekspropriuar në ditën kur vendimi mbi ekspropriimin e merr formën e prerë, ose në ditën që është caktuar në atë vendim, por jo para se të marrë formë të prerë vendimi mbi ekspropriimin.

Përfundimisht, Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës, në bazë të kërkesës së propozuesit i cili ka paraqitur dokumentin se i ka të siguruar mjetet për pagimin e kompenzimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuar, mund të vendosi që ajo pasuri e patundshme t'i dorëzohet në posedim para se të marrë formë të prerë vendimi mbi ekspropriimin, nëse konstaton se kjo është e domosdoshme për shkak të rastit urgjent, ose për të eliminuar dëme të konsiderueshme.

Kundër vendimit nga alineja 2 të këtij neni nuk mund të paraqitet ankesa, vetëm mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Në qoftë se në tokën e ekspropriuar ekziston ndërtesë, objekt tjetër ose pemë të mbjellura, organi kompetent për punët pasurore-juridike nuk mund t'ia dorëzojë në posedim atë pasuri të patundshme shfrytëzuesit të ekspropriimit, para se të sigurojë të dhënat mbi vlefën e asaj pasurie të patundshme në prezencën e propozuesit të ekspropriimit dhe pronarit të përparshëm.

Në qoftë se bëhet ekspropriimi i ndërtesës së banimit ose i banesës pjesë e veçantë e asaj ndërtese, shfrytëzuesit të ekspropriimit nuk mund t'i dorëzohet në posedim pasuria e patundshme e ekspropriuar gjersa mos t'u sigurojë shfrytëzuesi bartësve që kanë fituar të drejtën e banimit, shfrytëzimin e banesës tjetër gjegjëse, nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe.

Në qoftë se shfrytëzuesi i ekspropriimit ka hyrë në posedim të pasurisë së patundshme të ekspropriuar para se të marrë formë të prerë vendimi, e propozimi për ekspropriim në procedurë të mëtejme të jetë refuzuar në formë të prerë, shfrytëzuesi i ekspropriimit është i obliguar t'ia shpërblejë pronarit dëmin e shkaktuar me hyrjen në posedim.

Në rastet nga alineja 6 e këtij neni kur ekspropriimi bëhet në qytete dhe në vendbanime me karakter të qytetit kompensimin e dëmit që i është shkaktuar pronarit me hyrjen në pronësi e paguan personi shoqëroro-juridik për nevojat e të cilit është bërë ekspropriimi.

Në qoftë se kundër vendimit të kuvendit të komunës, me të cilin caktohet se ndërtimi i objektit ka interes të përgjithshëm nëse mund të fillojë ekspropriimi, ka filluar konflikti administrativ (neni 6 alineja 1 dhe 2), pasuria e patundshme për të cilën është marrë vendimi mbi ekspropriimin para përfundimit të atij konflikti, nuk mund t'i dorëzohet në posedim shfrytëzuesit të ekspropriimit gjersa mos të përfundojë ai konflikti.

Neni 21

Shfrytëzuesi i ekspropriimit, gjersa vendimi të merr formë të prerë, mund të heqi dorë tërësisht ose pjesërisht nga propozimi i ekspropriimit.

Nuk aprovohet dorëheqja e pjesërisht nga ekspropriimi nëse me këtë kishin me u cenuar të drejtat e pronarit të pasurisë së patundshme dhe nëse pronari paraqet ankesë të tillë.

Nëse shfrytëzuesi i ekspropriimit dhe pronari i përparshëm atë e kërkojnë së bashku, anulohet vendimi në formë të prerë mbi ekspropriimin.

Vendimi në formë të prerë mbi ekspropriimin do të anulohet edhe në bazë të kërkesës së pronarit të përparshëm, të pasurisë së patundshme të ekspropriuar, nëse shfrytëzuesi i ekspropriimit në afatin prej 3 vitesh ç'prej se vendimi ka marrë formë të prerë, nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punime të nevojshme në atë objekt.

Pasi të kalojnë dhjetë vjetë nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi ekspropriimin nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e atij vendimi.

Në lidhje me kërkesën për anulimin e vendimit mbi ekspropriimin dhe me heqjen dorë nga propozimi për ekspropriimin vendos organi i cili ka vendosur në shkallë të parë në lidhje me propozimin për ekspropriim, kurse marrëdhëniet pasurore midis shfrytëzuesit të ekspropriimit dhe pronarit të pasurisë

së patundshme, në rast konflikti do të rregullohen para gjykatës së kompetencës së përgjithshme.

KREU V

PROCEDURA E VEÇANTË PËR EKSPROPRIIMIN NË RAJONET E PËRFSHIRA NGA FATKEQËSITË ELEMENTARE PËRPJESTIMESH TË MËDHA

Neni 22

Në rajonet e përfshira nga tërmeti, vërshimet e fatkeqësitë tjera elementare, eksproprijimi për ndërtime e objekteve dhe kryerjen e punimeve me të cilat eliminohen pasojat e shkaktuara nga ato fatkeqësi bëhet në bazë të dispozitave të këtij kreu.

Neni 23

Rajonet në të cilat aplikohen dispozitat e këtij kreu, i cakton Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës.

Neni 24

Caktimin e interesit të përgjithshëm në rastet nga neni 22 i këtij ligji, e bën kuvendi i komunës. Padia kundër vendimit mbi caktimin e interesit të përgjithshëm nuk pengon ekzekutimin e vendimit mbi eksproprijimin.

Neni 25

Shfrytëzuesi i eksproprijimit fiton të drejtën e posedimit të pasurisë së patundshme të eksproprijuar kur bëhet definitiv vendimi mbi eksproprijimin.

Përfshirja, kuvendi i komunës, sipas kërkesës së propozuesit, mund të vendosë që pasuria e patundshme t'i dorëzohet në posedim edhe para se të jetë definitiv vendimi mbi eksproprijimin, nëse konstaton se ajo është e domosdoshme për shkak të rastit urgjent.

Neni 26

Në qoftë se eksproprijohet ndërtesa e banimit ose banesa si pjesë e veçantë e ndërtesës, shfrytëzuesi i eksproprijimit është i obliguar t'i sigurojë pronarit të përparshëm dhe bartësve të tjerë të së drejtës banesore të asaj ndërtese ose banesë tjetër gjegjëse brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 18 muaj, prej ditës, së shpërnguljes nga ndërtesa ose banesa e eksproprijuar.

Deri në sigurimin e banesës gjegjëse, shfrytëzuesi i eksproprijimit është i obliguar t'u sigurojë personave nga alineja paraprake, para se të rrëxohet ndërtesa e eksproprijuar, banimin e përkohshëm i cili i plotëson kushtet themelore të banimit (numrin e caktuar të dhomave, ndriçimin elektrik, ujin etj.).

Neni 27

Toka në të cilën ekziston e drejta pronësore, si dhe toka në pronësinë shoqërore, përkohësisht mund të zehet kur ekziston nevoja për ndërtimin dhe vendosjen e objekteve të përkohshme (objektet afariste, objektet për vendosjen e popullsisë etj.).

Vendimi me të cilin vendoset për nevojën dhe oportunitetin e zënies së përkohshme të tokës ka karakterin e vendimit mbi caktimin e interesit të përgjithshëm.

Ankesa e paraqitur kundër vendimit me të cilin konstatohet zënia e përkohshme e tokës nuk pengon zbatimin e vendimit.

Zënia e përkohshme e tokës hiqet posa mos të ekzistojë nevoja për të cilën është caktuar.

KREU VI

SHPËRBLIMI PËR PASURINË E EKSPROPRIUAR

1. Lartësia e shpërblimit

Neni 28

Shpërblimi për tokën bujqësore të eksproprijuar caktohet sipas çmimit në treg të tokës bujqësore.

Për çmim të tregut të tokës bujqësore merret çmimi i cili formohet në territorin e rajonit respektivisht vendbanimit në të cilin ndodhet toka bujqësore. Nëse çmimi i tregut nuk formohet në atë territor, në konsiderim merret çmimi i tregut i cili formohet në territorin fqinjë.

Në qoftë se në formimin e çmimit të tregut ndikojnë rrethanat që toka bujqësore ndodhet në vendbanimet ose në territoret turistike, ose në afërsi të këtyre vendbanimeve respektivisht territoreve afër komunikacionit, liqejeve artificial, kanaleve të meliorimit dhe objekteve tjera ose në vendet ku pritet eksproprijimi, shpërblimi zvogëlohet proporcionalisht nga ndikimi i këtyre rrethanave.

Në shpërblimin për tokën bujqësore të eksproprijuar, sipas dispozitave të alineve të përmendura pronarit të përparshëm i pranohet vlera e investimeve të deponuara të paamortizuara të vlefshme për ruajtjen e gjatë ose përmirësimin e tokës bujqësore.

Neni 29

Shpërblimi për 1 m² (një metër katror) të tokës ndërtimore të eksproprijuar caktohet në përqindjen nga çmimi mesatar në treg i cili formohet në vitin paraprak për një metër katror të lokalit të banimit, në atë vend ose pjesë të vendit, përqindje e cila nuk mund të jetë më e lartë 1% as më e vogël se 0,2%.

Kuvendi i komunës me aktin e vet përcakton përqindjen gjer në lartësinë e përqindjes nga alineja 1 të këtij neni për çdo vit më parë, e mëse voni gjer më 31 janar të vitit për të cilin merret vendimi.

Neni 30

Shpërblimi për objektet ndërtimore të eksproprijuar caktohet në bazë të vlerës ndërtimore të objektit të eksproprijuar.

Vlera ndërtimore e objektit ndërtimor të eksproprijuar përfshinë: vlerën e materialit, vlerën e punës fizike të nevojshme për ndërtimin e objektit, shpenzimet e transportit të materialit dhe shpenzimet e hartimit të dokumentacionit teknik. Vlera e shpërblimit e caktuar në bazë të vlerës ndërtimore zvogëlohet varësisht prej kohës së qëndrueshmërisë së objektit, respektivisht gjendjes në të cilin ndodhet objekti në momentin e caktimit të shpërblimit dhe mundësisë për shfrytëzimin e tij të mëtejme.

Neni 31

Kompensimi për vreshtin ose pemishten e eksproprijuar që japin fryte, caktohet në atë mënyrë që për tokë kompensimi caktohet sipas nenit 28 të këtij ligji dhe kësaj shume i shtohet shuma e investimeve të paamortizuara të deponuara për ngritjen dhe mirëmbajtjen e vreshtit ose të pemishtes së tillë dhe shuma e rendimenteve neto që do t'i ipte ky vresht ose kjo pemishte, duke pasur parasysh vjetërsinë dhe plleshmërinë e tij për aq vjet sa është e nevojshme të ngritet dhe të fillojë të japë fryte vreshti i ri ose pemishtja e re.

Kompensimi për vreshtin e ri ose pemishten e re të eksproprijuar që nuk japin fryte caktohet për tokën sipas dispozitës së nenit 28 të këtij Ligji dhe kësaj kompensimi i shtohet vlera e investimeve të deponuara për ngritjen e tyre.

Sipas dispozitave të alineve 1 dhe 2 të këtij neni caktohet kompensimi edhe për trungjet e veçanta të pemëve dhe për cungat e hardhisë që gjinden në tokën e eksproprijuar.

Neni 32

Kompensimi për fidanishten e ekspropriuuar caktohet sikur edhe për tokën bujqësore (neni 28). Kompensimi i caktuar në këtë mënyrë shtohet për vlerën e materialit mbëltues (fidanet dhe materialin tjetër për riprodhim), të cilin pronari nuk e ka shfrytëzuar deri në ditën e hyrjes në pronësi të shfrytëzuesit të eksproprijimit.

Neni 33

Kompensimi për pyllin e rritur ose për pyllin për afërsisht të rritur për prerje të ekspropriuuar, caktohet në bazë të vlerës së drujve në cung, ashtu që nga çmimi i caktuar me marrëveshjen shoqërore të sortimenteve që mund të prodhohen nga ai dru hiqen shpenzimet e prerjes, të përpunimit, të ngarkimit dhe të transportit deri në vendin e dërgimit.

Shpenzimet nga alineja 1 e këtij neni i përbëjnë të ardhurat personale dhe shpenzimet materiale që i llogarisin organizatat e punës së bashkuar për qeverisjen e pyjeve në atë rajon pyjorë-ekonomik.

Kompensimi për pyllin e ri të ekspropriuuar caktohet në bazë të shpenzimeve të ngritjes të situara me faktorin e rritjes së vlerës, ashtu që në kohën për afërsisht të rritjes për prerje ta arrijë vlerën e drurit në cung.

Kompensimit të caktuar sipas dispozitave të alineve 1 dhe 3 të këtij neni i shtohet kompensimi për tokën me pyje që caktohet në lartësinë e shpërblimit që do të caktohet për tokën më të afërt bujqësore të kualitetit përkatës.

Për tokën e pambuluar me pyje të ekspropriuuar shpërblimi caktohet në lartësinë e shpërblimit që do të caktohet për tokën më të afërt bujqësore të kualitetit përkatës.

Shpenzimet e ngritjes së pyellit të ri të krijuara në mënyrë artificiale caktohen në lartësinë e shpenzimeve të pyllzimit, ndërsa shpenzimet e ngritjes së pyellit të ri të krijuara në mënyrë natyrore caktohen në lartësinë e shpenzimeve të pyllzimit artificial me anën e farës.

Neni 34

Në pajtim me këtë ligj konsiderohet si pyll për afërsisht të rritur për prerje ai pyll i një moshë, i cili ka së paku të dy të tretat e moshës së pyellit të rritur, ndërsa si pyll i ri i një moshë konsiderohet ai pyll, i cili i ka deri në dy të tretat e moshës së pyellit të rritur për prerje.

Pylli i moshave të ndryshme (pylli i rralluar dhe pylli në grupe i moshave të ndryshme) konsiderohet pyll i rritur për prerje.

Neni 35

Kompensimi për tokën jo pjellore të ekspropriuuar caktohet në lartësinë e shpërblimit që do të caktohet për kullosën më të afërt të klasës më të ulët.

Neni 36

Dispozitat e noneve 31 deri 34 të këtij ligji aplikohen edhe në procedurën e caktimit të kompensimit për vreshtin, pemishten, fidanishten dhe për pyjet që gjenden në tokën e ndërtimit.

Neni 37

Me rastin e caktimit të shpërblimit për ndërtesën e ekspropriuuar si dhe pjesën e veçantë të ndërtesës për vlerësim merret edhe rrethana se shfrytëzuesi i eksproprijimit, në bazë të nenit 20 alineja 5 të këtij ligji, pronarit të mëparshëm dhe bartësve të të drejtës banesore të asaj ndërtese ose banese u ka mundësuar shfrytëzimin e banesës tjetër gjegjëse para se të bëhet rrëximi, ashtu që shpërblimi nga neni 30 mund të zvogëlohet deri në 10%.

Neni 38

Në qoftë se ekspropriohehet ndërtesa ose pjesa e veçantë e asaj ndërtese, ndërtuar pa lejen e nevojshme të organit kompetent shtetëror pas 15 shkurtit të vitit 1968 pronari i përparshëm nuk ka të drejtë në shpërblim për pronësinë e tillë të patundshme. Pronari i përparshëm mund ta rrënojë ndërtesën dhe të marrë materialin e asaj ndërtese në afat të cillin e cakton organi kompetent.

Neni 39

Gjendja personale dhe materiale e pronarit të përparmë merret në konsiderim me rastin e vlerësim të shpërblimit, nëse ato rrethana kanë vlerë të dukshme për ekzistencën e tij materiale.

Neni 40

Lartësia e shpërblimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuuar caktohet sipas rrethanave në momentin e marrjes së vendimit të shkallës së parë mbi shpërblimin.

Në qoftë se pasuria e patundshme e llojeve të ndryshme e ekspropriuuar i takon pronarit të njëjtë, me rastin e caktimit të shpërblimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuuar shpërblimi paraqitet veçmas për disa lloje të pasurisë së patundshme (toka, ndërtesat, stabilimentet etj.).

Neni 41

Në qoftë se bëhet ekspropriimi i tokës bujqësore në pronësi të bujkut shpërblimi mund të caktohet në tërësi ose pjesërisht duke iu dhënë në posedim pasuria tjetër e patundshme, vetëm në bazë të pëlqimit të tij.

Neni 42

Në qoftë se ekspropriohehet ndërtesa afariste ose lokal afarist, kuvendi komunal është i detyruar që me vendimin e vet t'i përcaktojë kushtet nën të cilat shfrytëzuesi i eksproprijimit ka për detyrë që para rrënim të objektit t'ia sigurojë shfrytëzimin e ndonjë ndërtese tjetër afariste, respektivisht të lokalit afarist, pronarit të mëparshëm, i cili merret me veprimtari të lejuar, për kryerjen e veprimtarisë së njëjtë.

Neni 43

Pronari i përparshëm nuk ka të drejtë shpërblimi për deponimet të cilat i ka bërë pas ditës kur është njohtuar me shkrim mbi propozimin e paraqitur për ekspropriim.

Neni 44

Në qoftë se shfrytëzuesit të eksproprijimit iu është dorëzuar pasuria e patundshme para se të marrë formë të prerë vendimi mbi ekspropriim, pronari ka të drejtë të zgjedhë që shpërblimi t'i caktohet sipas rrethanave në kohën e dorëzimit të pasurisë së patundshme ose në kohën e marrjes së vendimit të shkallës së parë.

Neni 45

Pronari i përparshëm i tokës së ekspropriuuar ka të drejtë t'i korrë të mbjellat dhe t'i mbledhë frytet. Organi kompetent për marrjen e vendimit mbi eksproprijimin, në rastet urgjente, sipas kërkesës së tij mund të lejojë shfrytëzuesin e eksproprijimit që në tokën e ekspropriuuar mund të fillojë zhvillimin e punimeve para se të vijë koha e korrjeve dhe e vjeljeve të të mbjellurave dhe fryteve.

Kundër vendimit nga alineja e përparme lejohet paraqitja e ankesës organit kompetent të shkallës së dytë. Ankesa nuk ndalon ekzekutimin e vendimit.

Në qoftë se pronari i përparshëm nuk ka qenë në gjendje t'i hoqë të lashtat ose t'i vjelë frytet për shkak se shfrytëzuesit të ekspropriimit i është lejuar që t'i fillojë punimet në tokën e ekspropriuar para heqjes së të lashtave ose vjeljes së fryteve, pronari i përparshëm ka të drejtë shpërblimi për të lashtat ose frytet pas zbritjes së shpenzimeve të nevojshme të cilat i kishte me i pasë gjer në korrije ose vjelje.

Neni 46

Në rastin e caktimit të servitutit shpërblimi caktohet në shumën për të cilën për shkak të caktimit të servitutit është pakësuar vlefia e tokës ose ndërtesës. Përtësia e vlefës së pakësuar të tokës ose ndërtesës caktohet sipas procedurës për caktimin e shpërblimit të caktuar me këtë ligj.

Neni 47

Në rast të caktimit të qirasë shpërblimi caktohet në lartësinë e qirasë që realizohet për tokat më të afërme të ngjashme.

Shpërblimi mund të caktohet në formë të shumës së menjëhershme për tërë kohën sa zgjatë qiraja ose në pagesa të kohëpaskohshme që bëhen në perioda të barabarta kohe.

Shpërblimi llogaritet prej ditës kur shfrytëzuesi i ekspropriimit ka hyrë në posedim të tokës.

Në qoftë se me caktimin e qirasë të tokës i është shkaktuar dëm efektiv, në shpërblim hyn edhe shuma e atij dëmi.

Neni 48

Shpërblimi për zënjën e përkohshme të tokës caktohet në lartësinë e në mënyrën si është caktuar me këtë ligj për shpërblimin në rastin e caktimit të qirasë.

2. Procedura për caktimin e shpërblimit

Neni 49

Pasi të marrë formë të prerë vendimi mbi ekspropriimin, organi komunal i administratës kompetent për punët juridike — pasurore është i obliguar që pa vonesë të caktojë dhe mbajë procesin verbal për caktimin me marrëveshje të shpërblimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuar.

Shfrytëzuesi i ekspropriimit është i obliguar t'i paraqesë organit nga alinea 1 e këtij neni ofertën me shkrim mbi lartësinë e shpërblimit dhe afatin i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë prej ditës kur vendimi mbi ekspropriimin ka marrë formë të prerë.

Organi nga alinea 1 e këtij neni i dërgon pa vonesë një kopje të ofertës pronarit të mëparshëm të pasurisë së patundshme të ekspropriuar dhe prej organeve të administratës dhe organeve tjera dhe organizatave merr informata mbi faktet që mund të jenë të rëndësishme për caktimin me marrëveshje të lartësisë së shpërblimit.

Neni 50

Në marrëveshjen mbi shpërblimin për pasurinë e patundshme të ekspropriuar duhet të jenë të caktuar, sidomos, forma dhe lartësia e shpërblimit dhe afati brenda të cilit shfrytëzuesi i ekspropriimit është i obliguar të përmbushi obligimin në pikëpamje të shpërblimit.

Marrëveshja mund të lidhet edhe mbi pjesën e shpërblimit.

Marrëveshja mbi shpërblimin ose pjesën e shpërblimit shënohet në procesverbal i cili duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e domosdoshme për përmbushjen e obligimit të shfrytëzuesit të ekspropriimit.

Procesverbali në të cilin është shënuar marrëveshja mbi shpërblimin ose mbi pjesën e shpërblimit ka fuqinë e aktit me karakter ekzekutiv.

Pasi që vendimi mbi ekspropriim të marrë formë të prerë palët nuk mund të merren vesh mbi lartësinë e shpërblimit jashtë procedurës së përcaktuar me këtë nen dhe me nenin 49 të kësaj ligje.

Neni 51

Një kopje e procesverbalit në të cilin, në vështrim të nenit 50 alinea 3 të këtij ligji është shënuar marrëveshja mbi shpërblimin për pasurinë e patundshme të ekspropriuar, i dërgohet avokatit kompetent publik.

Në qoftë se avokati publik vlerëson se palët kanë lidhur marrëveshjen mbi shpërblimin në dëm të bashkësisë shoqërore ia paraqet padinë gjykatës kompetente për anulimin e marrëveshjes mbi caktimin e shpërblimit. Padia paraqitet në afatin prej 15 ditësh prej ditës së marrjes të procesverbalit për marrëveshjen e lidhur mbi shpërblimin, e më së voni në afatin prej 6 muajsh prej ditës së lidhjes të marrëveshjes.

Padia e paraqitur ndalon pagesën e shpërblimit për pjesën kontestuese.

Neni 52

Në qoftë se marrëveshja mbi shpërblimin në tërësi nuk arrihet brenda afatit prej 3 muajsh prej ditës kur vendimi mbi ekspropriim ka marrë formë të prerë, organi komunal i administratës kompetent për punët juridike pasurore ia dërgon pa vonesë të gjitha aktet gjykatës komunale në territorin e së cilës gjendet pasuria e patundshme e ekspropriuar me qëllim të caktimit të shpërblimit.

Organi komunal i administratës mundet edhe para se të skadojë afati nga alinea 1 e këtij neni t'ia dërgojë gjykatës vendimin mbi ekspropriimin në formë të prerë me aktet nëse shifet haptazi se gjer të marrëveshja mbi shpërblim nuk do të arrihet.

Në qoftë se organi komunal nuk vepron sipas dispozitës nga alinea 1 e këtij neni, pronari i përparshëm i pasurisë së patundshme të ekspropriuar mund t'i drejtohet drejtpërdrejtë gjykatës për të caktuar shpërblimin.

Neni 53

Në qoftë se në procedurën e caktimit të kompensimit para gjykatës në pajtim me nenin 52 të këtij ligji, palët e lidhin marrëveshjen mbi kompensimin, gjykata komunale do t'ia dërgojë një ekzemplarë të kësaj marrëveshjeje avokatit kompetent publik.

Në qoftë se avokati publik e vlerëson se marrëveshja e lidhur nga alinea 1 e këtij neni është në dëm të bashkësisë shoqërore, mund t'ia paraqesë padinë gjykatës kompetente, në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimi të marrëveshjes.

Neni 54

Shpenzimet e procedurës për caktimin me marrëveshje të shpërblimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuar i paguan shfrytëzuesi i ekspropriimit.

Shpenzimet e procedurës gjyqësore për caktimin e shpërblimit i cakton gjykata proporcionalisht me suksesin e palëve në atë procedurë.

Neni 55

Shfrytëzuesi i ekspropriimit është i obliguar që në afatin prej 15 ditësh prej ditës së dorëzimit të vendimit në formë të prerë me të cilin është caktuar shpërblimi.

Shfrytëzuesi i ekspropriimit është i obliguar që në shumën e shpërblimit pronarit të përparshëm t'ia paguaj kamatën në lartësinë e kamatës së të hollave në kursim pa afat të caktuar në vjet prej ditës së hyrjes në posedim të pasurisë së patundshme gjer në kalimin e afatit nga alinea 1 e këtij neni, por jo për kohën para 15 shkurtit 1968.

Në qoftë se shfrytëzuesi i ekspropriimit në afatin nga alinea 1 e këtij neni, nuk i paguan pronarit të përparshëm shpërblimin është i obliguar që në shumën e shpërblimit të papaguar të paguaj kamatën

dyfishe nga alineja 2 të këtij neni prej ditës së kalimit të afatit e gjer në ditën e pagimit.

Dispozitat e alineve 2 dhe 3 të këtij neni aplikohen edhe në rast të pagimit të kompensimit për tokën e nacionalizuar ndërtimore.

Për kryerjen e obligimeve jo në të holla, afati caktohet me vendimin mbi shpërblimin.

Neni 56

Në qoftë se për shkak të eksportimit shuhet hipoteka, e drejta e marrjes së frytit ose ndonjë e drejtë tjetër efektive që ka ekzistuar para ekspropriimit të pasurisë së patundshme, shfrytëzuesi i ekspropriimit është i obliguar që shumën e shpërbimit ta depozojë pranë bankës në llogari të veçantë.

Në rast të kësaj banka i paguan shpërblimin pronarit të përparshëm të pasurisë së patundshme të ekspropriuar, respektivisht kërkesën e poseduesit të së drejtës efektive, vetëm në bazë të vendimit gjyqësor ose marrëveshjes së tyre me shkrim të legalizuar nga ana e organit kompetent.

Neni 57

Intabulimi i pronësisë dhe i të drejtave tjera në pasurinë e patundshme të ekspropriuar, mund të bëhet vetëm në qoftë se shfrytëzuesi i ekspropriimit, përveç dokumentave tjerë të nevojshme, i paraqet gjykatës vendimin mbi shpërblimin dhe vërtetimin e bankës se e ka paguar shpërblimin për pasurinë e patundshme të ekspropriuar.

Intabulimi i pronësisë dhe i të drejtave tjera në pasurinë e patundshme e cila është dhënë si shpërbim pronarit të përparshëm të pasurisë së patundshme të ekspropriuar, bëhet në bazë të vendimit në formë të prerë mbi ekspropriimin dhe mbi shpërblimin.

Kreu VII

EKSPROPRIMI I KOMPLEKSEVE TË TOKAVE PËR NEVOJAT E NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE DHE PREGATITJEN E RREGULLIMIN E TOKAVE

Neni 58

Për ndërtimin e objekteve ndërtimore dhe pregatitjen e rregullimin e tokave për ndërtim të tillë, mund të bëhet ekspropriimi i komplekseve të tokave.

Dispozitat e kësaj ligje që kanë të bëjnë me ekspropriimin e tërësishëm të pasurisë së patundshme aplikohen edhe në ekspropriimin e komplekseve të tokave për nevojat e ndërtimit të objekteve ndërtimore dhe pregatitjen e rregullimin e tokave për ato ndërtime, nëse nuk është caktuar ndryshe me dispozitat e këtij ligji, pos në qoftë se me aplikimin e dispozitave mbi tokën ndërtimore, kjo tokë nuk mund të kalojë në pronësinë shoqërore.

Neni 59

Kompleksi i tokave mund të ekspropriohehet për nevojat e ndërtimit të objekteve ndërtimore dhe pregatitjen e rregullimin e tokave vetëm në qoftë se për atë kompleks është nxjerrë plani i hollësishëm urbanistik.

Interesimi i përgjithshëm për nevojat e ndërtimit nga alineja 1 e këtij neni caktohet me planin e hollësishëm urbanistik.

Neni 60

Në qoftë se në tokën e ekspropriuar gjendet ndërtesa e cila në bazë të planit të hollësishëm urbanistik mund të ekzistojë në vendin në të cilin gjendet e është në gjendje të tillë sa nuk ka lehtëri të rriëxohet, ndërtesa e tillë nuk mund të ekspropriohehet.

Pronari i ndërtesës fiton të drejtën e shfrytëzimit të tokës që gjendet nën ndërtesë dhe tokën që është

e nevojshme për përdorimin e saj të rregullt, në ditën kur ajo tokë është bërë pronë shoqërore.

E drejta e shfrytëzimit të tokës nga alineja 2 e këtij neni zgjat gjersa të ekzistojë ndërtesa në atë tokë e nuk mund të bartet në person të tretë.

Në rast të bartjes së të drejtës së pronësisë në ndërtesën e cila gjendet në tokën në të cilën ekziston e drejta e shfrytëzimit, në pronarin e ri të ndërtesës kalon edhe kjo e drejtë.

Pronari i ndërtesës së banimit mund të ndërtojë në këtë tokë, në vend të ndërtesës ekzistuese ndërtesë të re në të cilën mund të ketë të drejtë pronësia nëse ai ndërtim është në pajtim me planin e hollësishëm urbanistik.

Neni 61

Kompleksi i tokës mund të ekspropriohehet për nevojat e ndërtimit të objekteve ndërtimore dhe pregatitjen e rregullimin e tokës vetëm në dobi të komunës në territorin e së cilës gjendet ai kompleks.

Tokën e ekspropriuar komuna mund t'ua japë në shfrytëzim personave juridikë për ndërtimin e ndërtesave dhe objekteve tjera dhe me qëllim të zhvillimit të punimeve tjera, në pajtim me planin e hollësishëm urbanistik.

Në pajtim me planin e hollësishëm urbanistik komuna mund të japë në shfrytëzim tokën e ekspropriuar edhe qytetarëve me qëllim të ndërtimit të ndërtesave në të cilën ata mund të kenë të drejtë pronësie, nëse ajo tokë është rregulluar për ndërtime të tilla.

Neni 62

Toka ndërtimore e pandërtuar e cila është bërë pasuri shoqërore e në bazë të ekspropriimit ose nacionalizimit, mbetet në posedim të pronarit të përparshëm gjer në ditën kur, në bazë të vendimit mbi marrjen nga posedimi, marrë nga ana e organit komunal të administratës kompetente për punët juridike-pasurore, është i obliguar t'ia dorëzojë komunës.

Pronari i përparshëm edhe para marrjes së vendimit mbi marrjen nga posedimi të tokës ndërtimore të pandërtuar, mund t'ia dorëzojë komunës, kurse komuna është e obliguar t'ia marrë atë tokë.

Në rastet nga alineja 1 dhe 2 të këtij neni pronarit të përparshëm i caktohet shpërbimi për tokë menjëherë pasi t'ia dorëzojë tokën komunës.

Neni 63

Pronari i përparshëm i tokës së pandërtuar ndërtimore e cila është bërë pronë shoqërore në bazë të ekspropriimit ose nacionalizimit, ka të drejtën prioritare për shfrytëzimin e asaj toke në sipërfaqen që është e nevojshme për ndërtimin e ndërtesës në të cilën ai mund të ketë të drejtë pronësore dhe për përdorimin e saj të rregullt në qoftë se në bazë të planit të hollësishëm urbanistik në ato mund të ndërtohet ndërtesë e tillë.

Neni 64

Pronari i përparshëm është i obliguar që brenda afatit prej 3 vjetësh prej ditës së marrjes së vendimit mbi dhënien e tokës në shfrytëzim t'ia ndërtojë ndërtesën.

Në qoftë se nuk vepron sipas dispozitës nga alineja 1 e këtij neni pronari i përparshëm hupë të drejtën prioritare në shfrytëzimin e tokës në të cilën ka qenë i obliguar të ndërtojë ndërtesën.

Shuarja e të drejtës prioritare në shfrytëzimin e tokës nga alineja 2 e këtij neni caktohet me vendimin e organit komunal të administratës kompetent për punët pronësore-juridike.

Neni 65

Bartësi i së drejtës nga neni 61 alineja 2 dhe 3 dhe i së drejtës së realizuar sipas nenit 63 të kësaj

ligje këto të drejta nuk mund t'i bartë në personin e tretë.

Të drejtën nga neni 61 alineja 3 të këtij ligji mund të trashëgojnë trashëguesit ligjorë personi të cilit i është dhënë toka në shfrytëzim me qëllim ndërtimi.

Neni 66

Bartësi i të drejtës nga neni 63 i këtij ligji këto të drejta mund t'i bartë në bashkëshortin, të paslindurit, të adoptuarit, prindët dhe adoptuesit etj.

Bashkëshorti, të paslindurit, të adoptuarit, prindët e adoptuesit, të drejtat nga alineja 1 e këtij neni nuk mund t'i bartin me veprim juridik në person të tretë.

Të drejtat nga alineja 1 e këtij neni mund t'i trashëgojnë trashëgimtarët e pronarit të përparshëm, ai dhe trashëgimtarët ligjorë të bashkëshortit, të paslindurit, të adoptuarit, prindët dhe adoptuesit, në të cilët pronari i përparshëm, në bazë të kësaj ligje, i ka bartur ato të drejta.

Neni 67

Dispozitat e nenit 64 të këtij ligji aplikohen edhe në personat në të cilët pronari i përparshëm ka bartur të drejtën e shfrytëzimit të realizuar sipas nenit 63 të këtij ligji, si dhe në personat të cilët e kanë trashëguar atë të drejtë, kurse afati prej 3 vjetësh për ndërtimin e ndërtesës fillon dhe në lidhje me këta persona prej ditës kur pronarit të përparshëm i është dorëzuar vendimi mbi dhënien e tokës në shfrytëzim.

Neni 68

Shfrytëzuesi i ekspropriimit (komuna) është i obliguar t'i paguaj shpërblimin pronarit të përparshëm brenda afatit prej 15 ditësh prej ditës së dorëzimit të vendimit me formë të prerë me të cilin është caktuar shpërblimi në të holla për tokën e përfshatuar.

Neni 69

Me rastin e ekspropriimit të komplekseve tokësore nuk aplikohen dispozitat e nenit 21 alineja 4 dhe 5 të këtij ligji.

Kreu VIII

BARTJA ADMINISTRATIVE E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË TOKËS NË PRONËSI SHOQËRORE ME QËLLIM NDËRTIMI

Neni 70

Interesi i përgjithshëm për bartjen administrative të tokës përcaktohet në pajtim me dispozitat e nënve 3 gjer 6 të këtij ligji, nëse me ligj të veçantë nuk është caktuar ndryshe.

Neni 71

Në qoftë se në tokën e cila bartet sipas dispozitës së nenit 64 të këtij ligji, gjindet ndërtesa ose objekte të tjera në pronësinë shoqërore, bashkësia shoqërore-politike organizata e punës së bashkuar, bashkësia vetëqeverisëse e interesit, bashkësia lokale, organizata shoqërore-politike organizata shoqërore e caktuar me ligj dhe organizata dhe bashkësia e tjetër vetëqeverisëse në të cilën bartet e drejta e shfrytëzimit të tokës, e fiton me këtë bartje dhe të drejtën e shfrytëzimit të ndërtesës ose të objektit tjetër, si dhe të gjitha të drejtat e tjera që i fiton shfrytëzuesi i ekspropriimit në pajtim me qëllimin për të cilin bëhet bartja.

Neni 72

Për të drejtat e marra në pikëpamje të tokës ose të pasurive të tjera natyrore, organizata e punës së bashkuar, respektivisht personi tjetër shoqëro-juridik, ka të drejtë në shpërblimin vetëm për punën dhe mjetet e deponuara në këtë tokë ose në pasurinë e tjetër natyrore.

Në qoftë se toka ose pasuria e tjetër natyrore paraqesin kushte të punës, organizata e punës së bashkuar, respektivisht personi tjetër shoqëro-juridik ka të drejtë në kompensimin me të cilin sigurohet që këto kushte të mos vështirësohen.

Për të drejtat e marra në pikëpamje të ndërtesave dhe të objekteve të tjera ndërtimore, organizata e punës së bashkuar, respektivisht personi tjetër shoqëro-juridik, ka të drejtë në kompensimin përkatës.

Kompensimin nga alineja 1 gjer 3 të këtij neni e paguan personi në të cilin bëhet bartja.

Neni 73

Në tokën në pronësinë shoqërore mund të caktohet e drejta e kalimit, transportimit, marrjes së ujërave, dhënies së gypave të ujësllësit, instalimit të mjeteve për përguarjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike dhe servituteve të tjera në dobi për bashkësitë shoqërore-politike, organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit, bashkësitë lokale, organizatat shoqërore-politike, organizatat shoqërore të caktuara me ligj dhe organizatat dhe bashkësitë e tjera vetëqeverisëse.

Kompensimi për institutimin e servitutit caktohet sipas dispozitave të nenit 72 të këtij ligji.

Neni 74

Toka në pronësinë shoqërore mund të zihet përkohësisht nëse kjo gjë është e nevojshme dhe oportune për ndërtimin e objekteve me interes të përgjithshëm, si dhe për rregullimin e asaj toke për një ndërtim të tillë.

Uzurpimi i përkohshëm mund të bëhet në dobi të bashkësisë shoqërore-politike të organizatës së punës së bashkuar, të bashkësisë vetëqeverisëse të interesit, të bashkësisë lokale, të organizatës shoqërore-politike, të organizatës shoqërore të caktuara me ligj dhe të organizatës dhe të bashkësisë tjetër vetëqeverisëse.

Për tokën e uzurpuar përkohësisht në pronësinë shoqërore caktohet kompensimi përkatës.

Në rastin e zënies së përkohshme shpërblimi për dëmin efektiv jepet gjithmonë, e shpërblimi tjetër jepet vetëm në qoftë se sipas dispozitave të këtij kreu do të jepej shpërblimi për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të tokës ose të drejtës tjetër.

Shpërblimi për zënien e përkohshme shkon në dobi të bartësit të së drejtës së shfrytëzimit ose të drejtës tjetër në tokën e zënë përkohësisht.

Neni 75

Vendimi mbi caktimin e servitutit ose zënies së përkohshme e merr organi komunal i administratës kompetent për punët juridike-pasurore.

Neni 76

Dispozitat e këtij ligji mbi ekspropriimin e pasurisë së patundshme aplikohen edhe për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të tokës ose të drejtës tjetër, përcaktimin e servitutit në tokën e pasurisë shoqërore dhe në zënien e përkohshme të tokës në pronësinë shoqërore, nëse nuk është caktuar gjë tjetër me dispozitat e këtij kreu.

Kreu IX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 77

Procedura për caktimin e shpërblimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuar do të zbatohet dhe shpërblimi do të caktohet sipas dispozitave të Ligjit mbi ekspropriimin («Fl. Zyrtare të KSAK», nr. 25/73) në të gjitha lëndët për të cilat, ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit mbi ekspropriimin («Fletorja Zyrtare e KSAK» nr. 25/73), nuk ka ekzistuar vendimi me formë të prerë mbi shpërblimin.

Neni 78

Në procedurën e caktimit të shpërblimit të gjyqi të gjitha parashtresat dhe vendimet janë të lira nga pagimi i taksës.

Neni 79

Dispozitat e nenit 55 të këtij ligji do të aplikohen edhe për të gjitha rastet në të cilat shpërblimi nuk është paguar gjer në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit mbi ekspropriimin («Fletorja Zyrtare e KSAK», nr. 25/73).

Neni 80

Vendimi nga neni 42 i këtij ligji kuvendi komunal do ta marrë më së voni në afat prej gjashtë muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të Ligjit mbi ekspropriimin («Fletorja Zyrtare e KSAK», nr. 19/77).

Neni 81

Dispozitat e Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi ekspropriimin («Fletorja Zyrtare e KSAK», nr. 19/77) mbi kompensimin aplikohet në të gjitha rastet, në të cilat kompensimi nuk është caktuar në mënyrë të plotëfuqishme deri në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi ekspropriimin («Fletorja Zyrtare e KSAK», nr. 19/77).

Në bazë të nenit 4 të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi inspekcionin arsimor («Gazeta Zyrtare e KSAK», nr. 3/78), Komisioni legjislativ i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 17 mars 1978, përcaktoi tekstin e spastruar të Ligjit mbi inspekcionin arsimor.

► Teksti i spastruar i Ligjit mbi inspekcionin arsimor, përfshin Ligjin mbi inspekcionin arsimor («Gazeta Zyrtare KSAK», nr. 1/70) dhe Ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi inspekcionin arsimor («Gazeta Zyrtare e KSAK», nr. 42/74) në të cilin është caktuar koha e hyrjes së tyre në fuqi.

KK nr. 011-3/1-78

Prishtinë 17 mars 1978

Kryetari i Komisionit
Muharrem Ymeri, d. v.

Case 1:13-cv-01001

Page 10

1. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of conspiracy to commit murder.

2. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

3. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

4. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

5. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

6. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

7. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

8. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

9. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

10. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

11. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

12. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

13. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

14. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

15. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

16. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

17. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

18. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

19. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

20. The Court finds that the Government's evidence is sufficient to establish that the defendant is guilty of the crime of murder.

Në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, jap

DEKRET

PER SHPALLJEN E LIGJIT PER NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT MBI EKSPROPRIMIN

Shpallet Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi eksproprium që e aprovoi Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar, më 21 nëntor 1986 dhe në mbledhjen e Dhomës Shoqërore-Politike, më 21 nëntor 1986.

KK Nr. 465-2/86
Prishtinë, 21 nëntor 1986

Kryetari i Kuvendit
Svetislav Dollasheviq, d.v.

LIGJI

PER NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT MBI EKSPROPRIMIN

Neni 1

Në Ligjin mbi eksproprium („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 21/78) — teksti i spastruar — pas nenit 2 shtohen dy nene të rinj:

„Neni 2a

Kompensimi për pasurinë e patundshme të ekspropriuuar caktohet në të holla.

Kompensimi për tokën bujqësore të ekspropriuar të buikut i cili atë tokë e ka burim të eksistencës i caktohet ashtu që i jipet në pronësi tokë tjetër përkatëse bujqësore.

Dispozitat e alinesë 2 të këtij neni nuk kanë të bëjnë me rastet kur shfrytëzuesi i ekspropriumit nuk ka dhe nuk mund të sigurojë tokë të tillë.

Sipas marrëveshjes së palëve kompensimi mund të caktohet edhe me dhënien e pasurisë tjetër të patundshme në pronësi në bashkëpronësi apo për shfrytëzim, përkatësisht në formë tjetër.

Neni 2b

Marrëveshja për kompensimin e pasurisë së patundshme të ekspropriuar lidhet para organit komunal të administratës që është kompetent për punët pronësore-juridike.

Nëse marrëveshja për kompensim nuk arrihet, kompensimin e cakton gjyqi në procedurën jashtë-kontestimore.

Procedura për caktimin e kompensimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuar është urgjente.

Kundër aktvendimit të plotëfuqishëm mbi caktimin e kompensimit nuk lejohet revizioni".

Neni 2

Në nenin 3 alinea 2 ndryshohet dhe bëhet:

"Në rast se nuk është nxjerrë plani detaj urbanistik, interesi i përgjithshëm përcaktohet me aktvendimin e kuvendit të komunës në territorin e të cilit gjendet pasuria e patundshme për të cilën mendohet të propozohet eksproprium, përkatësisht me aktvendimin e organit tjetër të autorizuar me ligj".

Neni 3

Pas nenit 3 shtohen tri nene të rinjë.

"Neni 3a

Interesin e përgjithshëm për ndërtimin e objektit të caktuar, respektivisht kryerjen e punëve tjera në tokën e cila gjendet në territorin e më shumë komunave, e përcaktojnë me marrëveshje komunat e interesuara, e nëse nuk arrihet marrëveshja këto e përcakton Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës.

Neni 3b

Pas marrjes së aktvendimit mbi përcaktimin e interesit të përgjithshëm për ndërtimin e objektit të caktuar, respektivisht kryerjen e punëve tjera në tokën e punueshme bujqësore, kuvendi i komunës apo organi tjetër i autorizuar me ligj është i obliguar të marrë mendimin e bashkësisë lokale në territorin e të cilës gjendet pasuria e patundshme të organizatës të punës së bashkuar që merret me veprimtari bujqësore në territorin e komunës dhe të institucionit profesional nga lëmi i bujqësisë.

Nëse nuk pranohen mendimet nga alinea 1 të këtij neni, kuvendi i komunës dhe organet tjera kompetente janë të obliguara t'i theksojnë shkaqet për çka nuk pranohen mendimet që janë dhënë.

Neni 3c

Nëse kundër aktvendimit mbi përcaktimin e interesit të përgjithshëm është hapur kontesti administrativ, procedura sipas propozimit për eksproprium nuk ndërprehet.

Nëse me aktgjykim është anuluar aktvendimi mbi përcaktimin e interesit të përgjithshëm, atëherë do të anulohet edhe aktvendimi mbi eksproprium".

Neni 4

Nenet 4, 5 dhe 6 fshihen.

Neni 5

Në nenin 12 alinea 2 në fund pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: „Komunës në territorin e të cilës gjendet pasuria e patundshme i pozuar për eksproprium.

Në nenin e njëjtë në alinenë 5 pas fjalës: „komunë shtohen fjalët apo organit tjetër të caktuar me ligj".

Neni 6

Në nenin 14 alinea 1 pika 2, pas fjalës: „mjetet" shtohen fjalët: „e ndara në llogari të veçantë".

Në nenin e njëjtë alinea 2 ndryshohet dhe bëhet:

"Nëse interesi i përgjithshëm për ndërtimin e objektit respektivisht për kryerjen e punëve tjera është përcaktuar me planin detaj urbanistik (neni 3 alinea 1) së bashku me propozimin për eksproprium paraqitet certifikata nga plani detaj urbanistik që ka të bëjë me kufijtë e tokës për qëllimin për çka ajo mund të përdoret".

Pas alinesë 2 shtohet alinea e re 3.

"Nëse interesi i përgjithshëm është përcaktuar me aktvendimin e kuvendit të komunës, respektivisht, organit tjetër të autorizuar me ligj (neni 3 alinea 2) bashkë me propozim për eksproprium paraqitet ai aktvendim".

Alineja e deritashme 3 bëhet alinea 4, kurse alinea 4 dhe 5 fshihen.

Në alinenë e deritashme 6 e cila bëhet alinea 5 fjalët: „nga alinea 1 deri 5, zëvendësohen me fjalët: „1 deri 4".

Neni 7

Në nenin 16 pas pikës 5 shtohen dy pika të reja 6 dhe 7:

"6. obligimin e pronarit të pasurisë së patundshme që t'ia dorëzojë në pronësi shfrytëzuesit të ekspropriumit, e në qytete dhe vendbanime me karakter qyteti në pronësi shfrytëzuesit të fundit, si dhe afatin e dorëzimit.

7. në qoftë se ekspropriohehet ndërtesa e banimit apo banesa si pjesë e veçantë e ndërtesës, respektivisht lokali afarist, shfrytëzuesi i ekspropriumit obligohet që pronarit, gjegjësisht shfrytëzuesit të mëparshëm dhe bartësit të të drejtës së banimit, respektivisht pronarit të lokalit afarist, ku e ka ushtruar veprimtarinë të sigurojë shfrytëzimin e banesës tjetër përkatëse respektivisht lokalit afarist".

Neni 8

Në nenin 20 alinea 5, pas fjalës: „Shfrytëzues" shtohen fjalët pronarit gjegjësisht shfrytëzuesit të mëparshëm.

Neni 9

Pas nenit 20 shtohen dy nene të rinjë.

"Neni 20a

Përmbarimi i aktvendimit mbi eksproprium nuk do të lejohet:

1. në ndërtesat e ekspropriuara të banimit, në banesa dhe lokalet afariste nëse shfrytëzuesi i ekspropriumit nuk i paraqet provat se e ka siguruar banesën përkatëse, respektivisht lokalit afarist;

2. në tokën e ekspropriuar dhe të marrë që është nën ndërtesë dhe në tokën që shërben për përdorim të rregullt të saj, të ndarë nga ekzekutimi në ndërtesë.

3. nëse përmbarimi është kushtëzuar me marrëveshje të palëve deri sa të plotësohen ato kushte.

Neni 20b

Kur në tokën e ekspropriuar ekzistonë ndërtesa, objekte e tjera apo të mbjellat, organi komunal

kompetent për punët pasurore-juridike shfrytëzuesit të eksproprijimit nuk mund t'i dorëzojë ato pasuri të patundshme para se të përcaktojë vlerën e atyre ndërtesave, objekteve tjera apo të mbjellave ose t'i sigurojë provat për vlerën e tyre.

Nëse shfrytëzuesit të eksproprijimit i është dorëzuar pasuria e patundshme para plotëfuqishmërisë së aktvendimit, e propozimi për eksproprijim në procedurën e mëtejme të jetë refuzuar në mënyrë të plotëfuqishme, shfrytëzuesi i eksproprijimit është i obliguar që pronarit t'ia kthejë pasurinë e patundshme dhe t'ia kompensojë dëmin.

Në qytete dhe vendbanime me karakter qyteti, obligimi i kthimit të pasurisë së patundshme dhe kompensimit të dëmit nga alinea 2 e këtij neni bie në shfrytëzuesin e fundit,

Në rast kontesti për marrëdhëniet pasurore-juridike në mes të shfrytëzuesit të eksproprijimit dhe pronarit të pasurisë së patundshme vendos gjykata e rregullt.

Neni 10

Në nenin 21 alinea 1 fjala: „gradual”, zëvendësohet me fjalën „tërësisht”.

Në alinen 3 të nenit të njëjtë në vend të pikës vëhet presja dhe shtohen fjalët: „përpos në rast të eksproprijimit të kompleksit të tokës”.

Në nenin e njëjtë, në alinen 5 numri 10, zëvendësohet me numrin „5”.

Pas alines 5 shtohen dy aline të reja:

„Kur është eksproprijuar kompleksi i tokës, aktvendimi i plotëfuqishëm mbi eksproprijimin do të anulohet me kërkesën e pronarit të mëparshëm, nëse në afat prej pesë vjetësh nga plotëfuqishmëria e aktvendimit në kompleksin e tokës nuk janë kryer punimet në përgatitjen dhe rregullimin e tokës.

Pas kalimit të afatit prej gjashtë vjetësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktvendimit mbi eksproprijimin e kompleksit të tokës nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e atij aktvendimi”.

Alinea e deritashme 6 bëhet alinea 8.

Neni 11

Në nenin 26 alinea 1, pas fjalës: „pronarit”, shtohen fjalët „gjegjësisht shfrytëzuesit”.

Në nenin e njëjtë, pas alinesë 2 shtohet alinea e re 3.

„Dispozitat e alinesë 1 dhe 2 të këtij neni, do të zbatohen me analogji edhe me rastin e eksproprijimit të lokalit afarist, ashtu që shfrytëzuesi i eksproprijimit është i obliguar që pronarit të lokalit afarist ku e ka ushtruar veprimtarinë, t'i sigurojë shfrytëzimin e lokalit tjetër afarist.

Neni 12

Në nenin 27 pas alinesë 4 shtohet alinea e re 5: „Nëse me dispozitat e nenit 22 deri 27 të këtij Ligji nuk është rregulluar ndryshe, në territorin e përfshirë nga fatkeqësitë e natyrës të vëllimit më të madh do të aplikohen dispozitat tjera të këtij ligji”.

Neni 13

Në nenin 28 alinea 1 pas fjalës: „tokë”, shtohen fjalët: „edhe toka ndërtimore në rajonin ndërtimor”.

Në nenin e njëjtë alinea 2, ndryshohet dhe bëhet:

„Çmimi i tregut i tokës së eksproprijuar bujqësore përcaktohet në bazë të të dhënave mbi vlerën qarkulluese, të cilat i jep shërbimi i të ardhurave shoqërore dhe të dhënave mbi shumën nga marrëveshjet që janë arritur për caktimin e kompensimit të drejtë për tokën e eksproprijuar në atë anë”.

Në alinen 3, në vend të pikës vëhet presje dhe shtohen fjalët: „mirëpo, jo më shumë se 50%”.

Pas alines 3 shtohen tri aline të reja:

„Në rastin nga alinea 3 e këtij neni kur objekt eksproprijimi është toka e punueshme bujqësore e

bujkut, e të ardhurat që i merr nga ajo tokë i janë bërë i ekzistencës, zvogëlimi i çmimit të tregut mund të jetë më së shumti gjer 10%.

Kuvendi i komunës me vendim i përcakton rajonet ku në formimin e çmimit të tregut ndikojnë rrethanat nga alinea 3 dhe 4 të këtij neni, si dhe përqindja më e vogël, e zvogëlimit të çmimit të tregut në ato rajone me rastin e caktimit të kompensimit.

Vendimi nga alinea paraprake merret për çdo vit më parë, e më së largu deri më 31 janar të vitit për të cilin merret vendimi”.

Alinea e deritashme 4 bëhet alinea 7.

Neni 14

Në nenin 29 alinea 1 ndryshohet dhe bëhet:

„Kompensimi për një metër katror të tokës së marrë ndërtimore të qytetit caktohet në përqindje të çmimit mesatar që formohet në vitin paraprak për një metër katror të lokalit banesor në ndërtimin shoqëror në atë vend, por që ajo përqindje nuk mund të jetë më e vogël se 0.2% e as më e madhe se 1%”.

Pas alines 1 të këtij neni shtohet alinea e re 2.

„Me çmim mesatar në kuptim të alines 1 të këtij neni nënkuptojmë çmimin e banesave të kryera në pronën shoqërore dhe çmimin e tregut të banesave”.

Alinea e deritashme 2 e këtij neni bëhet alinea 3.

Neni 15

Neni 30 ndryshohet dhe bëhet:

„Kompensimi për objektet e eksproprijuara ndërtimore, përveç ndërtesave ekonomike të prodhuesve bujqësorë, caktohet në bazë të vlerës ndërtimore të objektit të eksproprijuar.

Vlera ndërtimore e objektit të eksproprijuar përfshinë vlerën e materialit, vlerën e fuqisë punëtore që nevojitet për ndërtimin e objektit dhe shpenzimet e transportit të materialit që zvogëlohet varësisht nga afati i qëndrueshmërisë së objektit, respektivisht gjendja në të cilën gjendet objekti në momentin e caktimit të kompensimit dhe mundësisë për shfrytëzim të mëtejme.

Vlera ndërtimore në kuptim të këtij ligji përfshinë edhe shpenzimet e rregullimit të tokës ndërtimore, si dhe shpenzimet e hartimit të dokumentacionit teknik që i kompensohen.

1. pronarit të mëparshëm i cili ka bërë shpenzimet e tilla me rastin e ndërtimit të objektit të eksproprijuar:

2. pronarit të mëparshëm të ndërtesës së banimit të eksproprijuar apo të banesës, pa marrë parasysh se a ka pasur shpenzime të tilla në kohën e ndërtimit të objektit të eksproprijuar, nëse në ndërtesën e eksproprijuar apo në banesë ka banuar në momentin e paraqitjes së propozimit për eksproprijim e nuk kërkon sigurimin e banesës përkatëse, nëse fillon ndërtimin e ndërtesës së re.

3. pronarit të mëparshëm të lokalit të eksproprijuar afarist i cili në atë lokal në momentin e paraqitjes së propozimit për eksproprijim me punë personale ka ushtruar veprimtarinë e lejuar, nëse fillon ndërtimin e lokalit afarist, e nuk kërkon sigurimin e lokalit tjetër afarist.

Në rastet nga pika 2 dhe 3 të alines 3 të këtij neni, shfrytëzuesi i eksproprijimit do t'i kompensojë shpenzimet e rregullimit të tokës ndërtimore dhe dokumentacionit teknik pronarit të mëparshëm, i cili i paraqet provat se shpenzimet i ka paguar në afat prej një viti nga dita e pranimit të kompensimit për objektin ndërtimor”.

Neni 16

Pas nenit 30 shtohen katër nene të rinj:

„Neni 30-a

Nëse me veprimin e fatkeqësive të natyrës apo për shkak të tjera objekti i eksproprijuar është dëmtuar para eksproprijimit, vlera ndërtimore do të zvogëlohet në përproportion me atë dëmtim: shuma për të cilën zvogëlohet vlera ndërtimore llogaritet nëpërmes përproportionit të matjes dhe parallogarisë për përmirësimin e objektit.

Nëse objekti ndërtimor është vjetruar apo është dëmtuar në atë masë sa që nuk mund të përdoret, vlera ndërtimore e atij objekti caktohet në bazë të vlerës përdoruese të materialit.

Neni 30-b

Me rastin e caktimit të kompensimit për ndërtesën e eksproprijuar të banimit, banesë apo lokal afarist do të vlerësohen edhe rrethanat në të cilat shfrytëzuesi i eksproprijimit është i obliguar që pronarit të mëparshëm të asaj ndërtese, banese apo lokali afarist t'i sigurojë shfrytëzimin e banesës përkatëse apo lokalit afarist para rrënimit të tyre ashtu që vlera ndërtimore nga neni 30 të këtij Ligji mund të zvogëlohet deri 10%.

Vlera ndërtimore nga neni 30 i këtij Ligji nuk do të zvogëlohet nëse me marrëveshje të palëve pronarit të mëparshëm të ndërtesës së eksproprijuar të banimit, banesës apo lokalit afarist i jepet në pronësi apo bashkëpronësi një ndërtesë tjetër të banimit apo banesë ose lokal afarist.

Neni 30-c

Kompensimi për ndërtesat e eksproprijuara ekonomike ku pronari i mëparshëm apo anëtarët e familjes së tij kryejnë ndonjë prodhimtari të specializuar bujqësore, caktohet në lartësi të çmimit të tregut të atyre objekteve që formohet në atë vend, e nëse çmimi i tregut është më i vogël se vlera ndërtimore, në kuptim të nenit 30 të këtij Ligji, kompensimi caktohet në lartësi të vlerës ndërtimore.

Nëse pronari i mëparshëm apo anëtarët e familjes së tij nuk kanë kryer ndonjë prodhimtari të specializuar bujqësore në ndërtesën ekonomike të eksproprijuar, kompensimi caktohet në bazë të vlerës ndërtimore në kuptim të nenit 30 të këtij ligji.

Neni 30 d

Çmimi i materialit ndërtimor dhe materialit tjetër që nevojitet për ndërtimin e objektit caktohet sipas çmimit mesatar të atyre materialeve në shitje me pakicë në vendin ku gjendet objekti i eksproprijuar, respektivisht në vendin më të afërt ku ai material shitet.

Vlera e fuqisë punëtore që nevojitet për ndërtimin e objektit përcaktohet sipas çmimit mesatar të shërbimeve përkatëse, të cilat në atë ven i bëjnë organizatat e punës së bashkuar.

Neni 17

Neni 37 dhe 38 fshihen.

Neni 18

Neni 42 fshihet

Neni 19

Në nenin 43, në fund të alines në vend të pikës vëhet presje dhe shtohen fjalët: „përveç shpenzimeve që patjetër janë nevojite për shfrytëzimin e pasurisë së patundshme”.

Pas alines 1 shtohet alinea e re 2.

„Njoftimin për propozimin e paraqitur për eksproprium pronarit të mëparshëm ia dërgon organi kompetent për marrjen e aktvendimit mbi eksproprium”.

Neni 20

Në nenin 48 pas alines 1 shtohet alinea e re 2: „Kompensimi për veprimet përgatitore caktohet në lartësinë dhe mënyrën, ashtu si është parashikuar me këtë ligj për institucionin e qirasë, kështu që bazë për llogaritje të kompensimit merret koha e vazhdimit të veprimeve përgatitore”.

Neni 21

Pas nenit 50 shtohet neni i ri:

„Neni 50-a

Organi komunal i administratës kompetent për punët pronësore-juridike me aktvendim do të refuzojë lidhjen e marrëveshjes mbi lartësinë dhe formën e kompensimit për pasurinë e patundshme të eksproprijuar, nëse vlerëson se ajo marrëveshje është në kundërshtim me dispozitat e obligueshme për të drejtat vetëqeverisëse të njerëzve punues, për disponimin me mjetet shoqërore, me dispozitat tjera të obligueshme dhe rregullat e moralit të shoqërisë socialiste vetëqeverisëse.

Kundër aktvendimit nga alinea 1 e këtij neni nuk mund të paraqitet ankesa e as të hapet kontestativ administrativ.

Nëse organi i administratës e refuzon lidhjen e marrëveshjes për kompensim, pa shtyrje të gjitha shkresat e lëndës së eksproprijimit me aktvendimin mbi refuzimin e marrëveshjes do t'ia dërgojë gjykatës kompetente komunale për caktimin e kompensimit.

Nëse në procedurën e marrëveshjes ka marrë pjesë avokati publik si palë, organi nga alinea 1 e këtij neni nuk mund të refuzojë dhënien e pëlqimit për marrëveshjen e lidhur.

Neni 22

Në nenin 51 alinea 1 në fund të alinesë fshihet pika dhe shtohen fjalët: „me të gjitha shkresat e eksproprijimit në afat prej shtatë ditësh nga dita e lidhjes së marrëveshjes”.

Neni 23

Pas nenit 51 shtohen dy nene të rinjë:

„Neni 51-a

Në procedurën para organit komunal të administratës kompetent për punët pronësore-juridike apo parç gjykatës kompetente palët mund të merren vesh: për shumën në të holla të kompensimit, për dhënien e pasurisë tjetër të patundshme në pronësi në vlerën përkatëse, e nëse është fjala për ndërtesën e banimit apo banesë edhe në bashkëpronësi në vend të pasurisë së patundshme të eksproprijuar për pagimin reciprok të diferencave në vlerën e pasurisë së patundshme për vendosjen e objekteve të eksproprijuara në vendin tjetër të lejuar sipas dispozitave, për ndërtimin e hyrjeve, të vendkalimeve, dhe të rrugëve kaluese, si dhe për veprimet tjera të lejuara me ligj.

Nuk lejohet dhënia e kompensimit pronarit të mëparshëm, në vend të sigurimit, të banesës përkatëse apo lokalit afarist.

Neni 51-b

Marrëveshjen për kompensimin në të holla e ekzekuton gjykata komunale kompetente e marrëveshjen për format e tjera të kompensimit e ekzekuton organi i administratës, kompetent për punët pronësore juridike”.

Neni 24

Në nenin 52 alinea 3 ndryshohet dhe bëhet:
„Nëse organi komunal i administratës, kompetent për punët pronësore-juridike nuk vepron sipas dispozitës nga alinea 1 e këtij neni, pronari dhe shfrytëzuesi i mëparshëm i ekspropriumit drejtpërdrejt mund t'i drejtohen gjykatës për caktimin e kompensimit”.

Neni 25

Neni 55 ndryshohet dhe bëhet:
„Shfrytëzuesi i ekspropriumit është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit të plotëfuqishëm, me të cilin është caktuar kompensimi në të holla, t'ia paguajë pronarit të mëparshëm kompensimin.

Nëse shfrytëzuesi i ekspropriumit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit të plotëfuqishëm me të cilin është caktuar kompensimi në të holla, nuk ia paguan kompensimin pronarit të mëparshëm, është i obliguar që të njëjtit t'ia paguajë kamatën përkatëse.

Kamatë përkatëse konsiderohet kamata e cila në ditën e hyrjes në posedim deri te pagesa e kompensimit që i ka takuar pronarit të mëparshëm sikur shumën e paguar të mjeteve ky ta kishte deponuar në bankë të kursimit.

Shfrytëzuesi i ekspropriumit është i obliguar që në shumën e kompensimit pronarit të mëparshëm t'ia paguajë kamatën nga alinea 2 e këtij neni sipas dispozitave që vlejnë nga dita e hyrjes në posedim të pasurisë së patundshme deri te kalimi i afatit nga alinea 1 e këtij neni, mirëpo, jo para 15 shkurtit të vitit 1968.

Dispozitat e alines 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen edhe me rastin e pagesës së kompensimit për tokën ndërtimore të qytetit që është marrë.

Për përmbartimin e obligimeve jo në të holla, afati caktohet me marrëveshje të palëve, respektivisht me vendimin për kompensim.

Neni 26

Neni 56 ndryshohet dhe bëhet:
„Në ditën e plotëfuqishmërisë së aktvendimit për eksproprium në pasurinë e patundshme të ekspropriuuar shfuqizohen hipotekat, servitutet personale, të gjitha ngarkesat reale pos servituteve reale kryerja e të cilave është e mundurshme pas përcaktimit të destinimit të pasurisë së patundshme të ekspropriuuar.

Të drejtat reale nga alinea 1 e këtij neni fshihen në librat publike me propozimin e shfrytëzuesit të ekspropriumit.

Në rastet nga alinea 1 dhe 2 e këtij neni shfrytëzuesi i ekspropriumit është i obliguar që shumën e kompensimit ta deponojë të banka në llogari të veçantë, ashtu që me kompensim i deponon dhe kamatat e arritura. Banka do ta bëjë pagesën e kompensimit pronarit të mëparshëm, respektivisht kërkesat e poseduesit të së drejtës reale vetëm në bazë të marrëveshjes së tyre me shkrim, të vërtetuar nga ana e organit kompetent apo në bazë të vendimit të gjyqit”.

Neni 27

Në nenin 59 alinea 1 në fund fshihet pika dhe shtohen fjalët: „edhe nëse ndërtimi i objekteve ndërtimore është parashikuar me planin afatmesëm të bashkësisë përkatëse shoqërore politike”.

Neni 28

Neni 63 ndryshohet dhe bëhet:
„Pronari i mëparshëm i tokës së ekspropriuuar në kuptim të nenit 58 të këtij ligji ka të drejtën e përparësisë që ta marrë në shfrytëzim atë tokë për ndërtimin e ndërtesës në të cilën sipas ligjit mund të

fitojë të drejtën e pronësisë, në kufijtë e një ngastre ndërtimore, e cila sipërfaqe nevojitet për përdorim të rregullt të ndërtesës nëse në bazë të planit detaj urbanistik në atë tokë mund të ndërtohet një ndërtesë e tillë (e drejtë e përparësisë së ndërtimit). Sipas kushteve dhe në atë mënyrë si është parashikuar në Ligjin mbi tokën ndërtimore”.

Neni 29

Nenet 64, 65 dhe 66 fshihen.
Titulli i kapitlës VIII para nenit 70 ndryshohet dhe bëhet:

„MARRJA, PËRKUFIZIMI DHE BARTJA E TË DREJTËS NË PASURINË E PATUNDSHME NË PRONËN SHOQËRORE (BARTJA ADMINISTRATIVE)”

Neni 30

Neni 70 ndryshohet dhe bëhet:

„E drejta e organizatës të punës së bashkuar dhe personit tjetër shoqëroro-juridik në pikëpamje të pasurisë së patundshme në pronën shoqërore me aktvendimin e organit komunal të administratës kompetent për punët pronësore-juridike mund të merret apo të kufizohet dhe të bartet në organizatën tjetër të punës së bashkuar apo të personi tjetër shoqëroro-juridik vetëm nëse këtë e kërkojnë në bazë të nevojave të përcaktuara me ligj rregullimi i hapësirës me plan apo ndërtimi i objektit me rëndësi shoqërore apo interesi tjetër i përgjithshëm i përcaktuar me Ligj.

Interesi i përgjithshëm për marrjen apo përkufizimin e atyre të drejtave përcaktohen në mënyrën e cila është caktuar me Ligj për ekspropriumin e pasurisë së patundshme”.

Neni 31

Neni 71 fshihet

Neni 32

Në nenin 72 alinea 3 dhe 4 fshihen.

Neni 33

Pas nenit 72 shtohen dy nene të rinjë:

„Neni 72-a

Për të drejtat që janë marrë në pikëpamje të ndërtesave dhe objekteve tjera ndërtimore organizata e punës së bashkuar, respektivisht personi tjetër shoqëroro-juridik ka të drejtë kompensimi edhe përkishtë:

1. në lartësinë e cila nevojitet për blerjen e një ndërtese apo objekti të tillë, nëse ndërtesa apo objekti kanë qenë kusht për punë apo bazën materiale të organizatës të punës së bashkuar, respektivisht personit tjetër shoqëror-juridik.

2. në lartësi prej vlerës ndërtimore të përcaktuar në kuptim të nenit 30 të këtij Ligji, nëse ndërtesa apo objekti është fituar nga bartja me kompensim, me blerje apo me financimin e ndërtimit, e nuk kanë qenë kusht për punë as për bazën materiale të organizatës të punës së bashkuar, respektivisht të personit tjetër shoqëror-juridik.

3. në lartësi të mjeteve të deponuara në fitimin dhe mirëmbajtjen investicionale, nëse ndërtesat apo objektet janë fituar me bartje apo në bazë të aktit të organit kompetent, e nuk kanë qenë kusht për punë as bazë materiale të organizatës së punës së bashkuar, respektivisht personit tjetër shoqëror-juridik.

Neni 72-b

Kompensimi caktohet në të holla, e me marrëveshje të palëve dhe me dhënien e pasurisë tjetër të patundshme.

Kompensimin nga neni 72 dhe 72-a të këtij ligji e paguan personi shoqëror-juridik në të cilën bartet e drejta".

Neni 34

Neni 73 ndryshohet dhe bëhet:

"Në tokën në pronësinë shoqërore mund të caktohet e drejta e servitutit të kalimit, transportimit, marrjes së ujit, instalimit të objekteve për përquarjen e energjisë elektrike dhe servituteve tjera në dobi të personave shoqërorë-juridikë.

Për institutimin e servitutit caktohet kompensimi në shumën e cila, për shkak të institutimit të servitutit, është zvogëluar vlera e tokës apo e ndërtesës".

Neni 35

Në nenin 74 alineja 3 fshihet fjala „përkatëse” si dhe pika në fund të alinesë dhe shtohen fjalët në lartësi të qirasë që realizohet për tokën e ngjashme me të afërt.

Pas alinesë 3 shtohet alineja e re 4.

„Kompensimi nga alineja 3 e këtij neni nuk përjashton të drejtën në kompensimin e dëmit sipas dispozitave dhe përgjegjësisë për dëmin".

Alineet e deritashme 4 dhe 5 fshihen.

Neni 36

Neni 76 ndryshohet dhe bëhet:

„Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohet ekspropriimi i pasurisë së patundshme, aplikohen me rastin e marrjes, përkufizimit dhe bartjes të së drejtës për pasurinë e patundshme në pronën shoqërore, nëse me dispozitat e nenit 70 dhe 75 të këtij ligji nuk është caktuar ndryshe."

Neni 37

Pas nenit 77 shtohen dy nene të rinjë:

„Neni 77-a

Dispozitat e këtij ligji do të aplikohen në të gjitha lëndët që nuk kanë përfunduar në mënyrë të plotëfuqishme deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 77-b

Organi komunal i administratës kompetent për punët pronësore-juridike mban evidencën mbi ekspropriimin e pasurisë së patundshme për territorin e komunës.

Përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës mbi ekspropriimin e pasurisë së patundshme e rregullon drejtori i Drejtorisë Krahinore për punët pasurore-juridike.

Të dhënat e mbledhura të evidencës nga alineja 1 e këtij neni për çdo tre muaj, organi kompetent komunal ia dërgon Drejtorisë Krahinore për punët pasurore-juridike".

Neni 38

Neni 80 fshihet.

Neni 39

Autorizohet komisioni legjislativo-juridik i Kuveudit të KSA të Kosovës të përcaktojë tekstin e spas-truar të Ligjit mbi ekspropriimin.

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tërë nga dita e shpalljes në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës".